

1. Raportimi javor date 15.06.2019

Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: Eleda Dhima
Partia/subjekti elektorale: Partia e Emigracionit Shqiptar
Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:

Nga komunikimet me Partinë e Emigracionit Shqiptar kam marrë prej saj programin e për fushatën elektorale. Kjo parti nuk ka zyra elektorale dhe takimet me elektoratin i ka planifikuar që të kryej në ambiente të anatareve të partise si bar kafe ose në ambiente të hapura. Kjo parti ka mundësi të kufizuara për organizime të mëdha edhe për shkak përhapjes së saj jo në të gjithë territorin e vendit me strukturë të saj si dhe të mundësive të pakta ekonomike. Sipas programit elektorale takimet elektorale me lagje e fshatra do të jenë masive nga data 16 e në vazhdim. Këto takime do të pasqyrohen nga ana ime edhe me foto të ndryshme.

Zyrat elektorale

Me shkresën nr3791/1 datë 11.06.2019 Bashkia Gramsh më informon se nuk ka zyrë elektorale në territorin e kësaj Bashkie për Partinë e Emigracionit Shqiptar.

Po kështu edhe Bashkia Kelcyre me shkresën nr 1318 datë 11.06.2019 më informon se nuk ka zyrë elektorale në territorin e kësaj Bashkie për Partinë e Emigracionit Shqiptar.

Materiale të fushatës të ndaluara

Deri tani kjo parti nuk ka shpërndarë materiale elektorale.

Audituese Ligjore

Eleda Dhima



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KËLCYRË

Nr 1312 Prot

Këlcyrë më. 11.06 /2019

Lënda : Informacion mbi kërkesën tuaj

AUDITUES LIGJOR ELEDA DHIMA
Adresa :Lagjia « Xhevdet Nepravishta »
Lushnje

Në përgjigje të shkresës tuaj,protokolluar me tonën Nr.1307 Prot, datë 11.06.2019 në të cilën keni kërkuar « Kërkim informacioni mbi vendodhjen e zyrave elektorale për subjektin zgjedhor « Partia Emigracioni Shqiptar», ju bëjmë me dije se :
Nga verifikimet e kryera nga administrata e bashkisë Këlcyrë, rezulton se subjekti zgjedhor « Partia Emigracioni Shqiptar » nuk ka zyra elektorale të hapura në territorin e bashkisë Këlcyrë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin !

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr 3781/prot.
1

Gramsh, më 11/10/2019

Lënda: Dërgohet informacioni për adresat e sakta të zyrave elektorale për subjektin zgjedhor "Partia Emigracioni Shqiptar"

Drejtuar: Znj.ELEDA DHIMA,
Lagjia "Xhevdet Nepravishta", Lushnje

Në përgjigje të shkresës tuaj, ku kërkonte informacion për zyrat elektorale të Partisë Emigracioni Shqiptar, ju bëjmë me dije se:

Në territorin e Bashkisë Gramsh kjo parti nuk ka zyrë elektorale. Ky informacion është marrë nga verifikimi në terren i punonjësve të Policisë Bashkiake, pasi ky subjekt zgjedhor deri më sot nuk na ka vënë në dijeni lidhur me numrin e zyrave elektorale, kjo në kundërshtim me udhëzimin Nr.1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", ku çdo subjekt është i detyruar të njoftojë jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi Kryetarin e Bashkisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

